



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Kur shërbimet e veçanta shndërrohen në shkelje: një analizë mbi praktikat e institucioneve publike

Dhjetor 2024





QEVERISJE E MIRË

AUTORE:

Rita Sekiraqa



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Deklarata mohuese: Ky raport është publikuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian (BE). Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti "Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe eficiencës në shpenzimin e parasë publike përmes prokurimit publik në Kosovë" i financuar nga BE, zbatohet nga Demokraci Plus (D+).

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	6
Hyrje	7
Përmbledhje e të gjeturave.....	8
Angazhimi i ekspertëve për hartim të politikave.....	10
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	10
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	11
Angazhimi i ekspertëve për punë teknike-administrative sipas nevojave të institucionit ...	12
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	12
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2)	14
Komuna e Prizrenit	16
Komuna e Pejës.....	18
Angazhimi i ekspertëve për shërbime të IT-së	20
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.....	20
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	21
Komuna e Vitisë	23
Angazhimi i ekspertëve për përfaqësim në gjykatë.....	25
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2).....	25
Komuna e Prishtinës.....	26
Përfundime dhe rekomandime	28

Lista e shkurtesave

AK →	Autoriteti Kontraktues
AKA →	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AUV →	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
DMZP →	Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
KRPP →	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP →	Ligji i Prokurimit Publik
MASHTI →	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFPT →	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT →	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MKRS →	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI →	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB →	Ministria e Punëve të Brendshme
MShV →	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta
TeR →	Termet e Referencës

Hyrje

Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta (MShV) janë kontrata që lidhen ndërmjet një institucioni publik dhe një individi për të ofruar një shërbim të caktuar që është jashtë kapacitetit apo stafit të rregullt të institucionit. MShV-të fillimisht kanë qenë të rregulluara me Ligjin për Shërbimin Civil, mirëpo me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik, lidhja e këtyre kontratave i është lënë legjislacionit të prokurimit publik. Meqenëse Ligji i ri për Prokurim Publik nuk është përgatitur ende, lidhja e këtyre kontratave nga institucionet publike është rregulluar me Rregulloren për Prokurim Publik¹.

Sipas Rregullore në fjalë, këto kontrata:

1. Përdoren për angazhime të konsulentëve/kontraktorëve individual që nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik (neni 57.2);
2. Shërbime të veçanta janë ato shërbime profesionale të cilat institucioni publik nuk mund t'i plotësojë me stafin që ka (57.3);
3. Konsulenti/kontraktori është specialist i fushës specifike dhe angazhohet në rolin e këshiluesit (57.4);
4. Konsulenti/kontraktori është person fizik nga të cilët nuk kërkohet të kenë biznes të regjistruar, por të regjistrohen në platformën E-prokurimi si person fizik (57.5);
5. Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit të veçantë është 36 muaj (57.8);

6. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të katër kriterëve: a) përvoja përkatëse; b) cilësia e metodologjisë së propozuar; c) kualifikimi dhe d) transferimi i njohurisë (nëse kërkohet) – (neni 57.14);
7. Secili nga kriteret si më lartë peshohet me pikë i cili kur të bashkohet me propozimin financiar (i cili merr max. 30 pikë), nxjerrë pikët totale për një kandidat.

Demokrasi Plus (D+) në vitin 2022² dhe 2023³ ka publikuar raporte monitoruese mbi këtë temë dhe vazhdimisht avokon te institucionet publike për mos keqpërdorim në lidhjen e këtyre kontratave. Raporti aktual është i treti me radhë në të cilin paraqiten raste të keqpërdorimeve nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal. Në mënyrë të përmbledhur, ato janë grupuar në disa tituj kur institucionet pa të drejtë lidhin kontrata me ekspert me qëllim a) hartim të politikave/strategjive; b) angazhimi i ekspertëve për punë teknike-administrative sipas nevojave të institucionit; c) angazhimi i ekspertëve për shërbime të IT-së dhe d) angazhim i ekspertëve për përfaqësim në gjykatë.

1 Ky raport bazohet në Rregulloren e prokurimit publik 001/2022 sepse hulumtimi i tenderëve përkatës është bërë para se të ndryshohet dhe plotësohet kjo rregullore e cila ka hyrë në fuqi më 11.11.2024. Po ashtu, ky ndryshim/plotësim nuk ka ndryshuar përmbajtjen nga rregullorja paraprake, sa i përket mënyrës se si lidhen MShV-të. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Rregullore e prokurimit publik 001/2022, neni 57, 2022. https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

2 Democracy Plus, Keqpërdorimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta në komuna dhe ministri, 2022. <https://dplus.org/publikimet/keqperdorimi-i-marreshjeve-per-sherbime-te-vecanta-ne-komuna-dhe-ministri/15454/>. (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

3 Democracy Plus, Keqpërdorimi i marrëveshjeve për shërbime të veçanta në nivelin qendror, 2023. <https://dplus.org/publikimet/keqperdorimi-i-marreshjeve-per-sherbime-te-vecanta-ne-nivelin-qendror/17526/>.

Përmbledhje e të gjeturave

Të gjeturat në vijim janë grupuar sipas temave të raportit:

Angazhimi i ekspertëve për hartim të politikave

- MMPHI ka shpërblyer me kontratë konsulentin i cili nuk kishte ofruar metodologji të punës, edhe pse kjo ka qenë kërkesë e Ministrisë përmes së cilës do të bëhej vlerësimi teknik i ofertës, e në anën tjetër ka vlerësuar të njëjtin kandidat me pikë maksimale për këtë kriter;
- MINT ka angazhuar ekspert ndërkombëtar për hartim të strategjisë, në kundërshtim me LPP (nenin 7). Duke titulluar tenderin “Angazhim i një eksperti ndërkombëtar” MINT ka eliminuar të gjithë ekspertët vendor që kanë përvojën relevante për të aplikuar në tender.

Angazhimi i ekspertëve për punë teknike-administrative sipas nevojave të institucionit

Komuna e Prizrenit

- Komuna e Prizrenit ka shfrytëzuar MShV-të për të kontraktuar konsulentë të cilët kryejnë punë të rëndomta teknike-administrative, që do të duhej të realizoheshin nga stafi aktual i komunës;
- Komuna nuk ka respektuar Rregulloren për Prokurim Publik për caktimin e duhur të kriteve për vlerësim teknik të ofertave duke mos kërkuar nga kandidatët njërin ndër kriteret obligative që është metodologjia e punës;
- Komuna nuk ka vlerësuar ofertat e kandidatëve duke peshuar çdo kriter me pikët e dhura ashtu siç e përcakton Rregullorja për prokurim publik,

kështu ka shfrytëzuar MShV-të për kontraktimin e kandidatëve jo kompetent për kryerjen e punëve të përcaktuara në dosje të tenderit.

MKRS

- MKRS nuk ka respektuar LPP-në duke përcaktuar një afat më të shkurtë për dorëzim të ofertave, pa ndonjë arsye specifike, sesa ai që është paraparë me ligj. Po ashtu, nuk ka përcaktuar sipas Rregullores kriteret për vlerësim teknik të ofertave, duke mos kërkuar fare metodologjinë e punës e cila është obligative.
- MKRS ka kontraktuar ekspert për kryerjen e punëve që duhet të mbulohen nga stafi aktual i Ministrisë, e po ashtu ka shfrytëzuar MShV-të për zgjatje të afatit të punës për konsulentët e kontraktuar përmes prokurimit për shërbime të veçanta. Nuk ka paraqitur mënyrën e vlerësimit me pikë të caktuara për çdo nënkriter, për kandidatët ofertues, ashtu siç e përcakton Rregullorja për prokurim publik.

Komuna e Pejës

- Komuna e Pejës nuk ka përcaktuar sipas Rregullores kriteret për vlerësim teknik të ofertave, duke mos kërkuar fare metodologjinë e punës e cila është obligative dhe ka shfrytëzuar MShV-të për zgjatje të afatit të punës për konsulentët e kontraktuar përmes prokurimit për shërbime të veçanta. Po ashtu, ka caktuar si anëtar të komisionit vlerësues të tenderëve një person të kontraktuar me MShV për një tender tjetër e jo specifikisht për vlerësim të ofertave ashtu siç e përcakton ligji.
- Komuna e Pejës ka kontraktuar kandidatë të cilët kanë ofertuar me biznes e jo si konsulent individual ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit, kandidatë jo kompetent për kryerjen e punëve të përcaktuara në dosje të tenderit.

Angazhimi i ekspertëve për shërbime të IT-së

MASHT

- MASHTI nuk ka përcaktuar sipas Rregullores kriteret për vlerësim teknik të ofertave, duke mos kërkuar fare metodologjinë e punës e cila është obligative. Ka shfrytëzuar MShV-të për zgjatje të afatit të punës për konsulentët e kontraktuar përmes prokurimit për shërbime të veçanta.
- MASHTI ka kërkuar të kontrakttojë ekspert për kryerjen e punëve që duhet të mbulohen me stafin aktual të Ministrisë dhe ka paraqitur kërkesa minimale lidhur me përvojën e punës për të kontraktuar ekspert/konsulent.

AUV

- AUV nuk ka përcaktuar kriteret për vlerësim teknik të ofertave sipas Rregullores për Prokurim Publik, duke përfshirë edhe ofertën financiare, kur ajo duhet të peshohet në fund pas përcaktimit të pikëve të vlerësimit teknik.
- AUV nuk ka paraqitur mënyrën e vlerësimit me pikë të caktuara për çdo kriter, për kandidatët ofertues, ashtu siç e përcakton Rregullorja dhe ka kontraktuar ekspert për kryerjen e punëve që duhet të mbulohen me stafin aktual të Agjencisë, duke paraqitur kërkesa minimale lidhur me përvojën e punës për të kontraktuar ekspert/konsulent.

Komuna e Vitisë

- Komuna e Vitisë nuk ka përcaktuar sipas Rregullores nënkriteret për vlerësim teknik të ofertave, duke mos kërkuar fare metodologjinë e punës e cila është obligative dhe ka paraqitur kërkesa minimale lidhur me përvojën e punës për të kontraktuar ekspert/konsulent.

- Komuna nuk i ka paraqitur saktësisht të dhënat në lidhje me vlerën e tenderit duke shkaktuar paqartësi të kandidatët e interesuar për ofertim dhe nuk ka respektuar afatin kohor për caktimin e afatit për dorëzim të ofertave sipas Ligjit për Prokurim Publik. Po ashtu, nuk ka paraqitur mënyrën e vlerësimit me pikë të caktuara për çdo nënkriter, për kandidatët ofertues, ashtu siç e përcakton Rregullorja.

Angazhimi i ekspertëve për përfaqësim në gjykatë

MASHT

- MASHTI nuk ka përfshirë në vlerësim teknik kritere që sipas Rregullores për Prokurim Publik do të duhej që patjetër të përfshiheshin dhe ka paraqitur kërkesa minimale lidhur me përvojën e punës për të kontraktuar ekspert/konsulent për AKA-në, dhe si rrjedhojë ka kontraktuar kandidatë jo kompetentë për t'u cilësuar si ekspert.

Komuna e Prishtinës

- Komuna e Prishtinës nuk ka respektuar procedurën ligjore e cila duhet të përdoret për lidhjen e MShV-ve. Komuna ka përcaktuar si kriter “tenderi me çmimin më të ulët”, ndërsa kriteri “tenderi ekonomikisht më i favorshëm” është ai që përdoret për lidhjen e MShV-ve. Sikurse edhe më herët, komuna ka kontraktuar kompani për punë (përfaqësim ligjor) të cilat do të duhej të mbuloheshin nga sektori ligjor në komunë.

Angazhimi i ekspertëve për hartim të politikave

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në janar të 2024 ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin “Kontraktimi i dhjetë (10) ekspertëve për programin e banimit të përbalueshëm në Republikën e Kosovës”⁴. Tenderi në fjalë është i ndarë në pesë (5) lloje, me vlerë të parashikuar 105,600.00 euro dhe kohëzgjatje prej 12 muajve.

MMPHI përmes këtij tenderi ka paraparë angazhimin e ekspertëve në fushat si: profesionist i fushës së politikave të banimit (një pozitë), arkitekt për përgatitjen teknike të projekteve për banim të përbalueshëm (tre pozita), profesionist i fushës për ndërtimtari (dy pozita), profesionist i fushës për ekonomi (dy pozita) dhe profesionist i fushës për juridik (dy pozita). Pas shqyrtimit të dokumentacionit të këtij tenderi, hulumtuesit e D+ kanë konstatuar parregullsi sa i përket përshtatshmërisë së kandidatëve të rekomanduar për kontratë.

Kandidati i rekomanduar për kontratë për pozitën profesionist në fushën e politikave të banimit, edhe pse mjaft i përgatitur nga ana e kualifikimit dhe përvojës së punës, në ofertën e tij nuk ka paraqitur metodologjinë e punës. Kjo ka qenë kërkesë e MMPHI-së e cila te vlerësimi teknik i propozimeve ka përcaktuar metodologjinë e punës si nënkriter me 30 pikë. Në vlerësimin e bërë nga MMPHI ku paraqitet vlerësimi i secilit kandidat për çdo nënkriter të përcaktuar, shihet se kandidati në fjalë është vlerësuar me 30 pikë të nënkriterit të metodologjisë, pa e dorëzuar fare këtë dokument. Pastaj, kandidati i kontraktuar për pozitën arkitekt për përgatitjen teknike të projekteve për banim të përbalueshëm, vërehet se përvoja e tij e punës është mjaft e mangët. Sipas CV-

së dhe referencave të ofruara nga kandidati, shihet se përvoja e tij si arkitekt është e përqendruar në plane dhe dizajne të arkitekturës, dizajn të enterierit ose si arkitekt i pavarur (edhe pse për këtë të fundit nuk ka asnjë dëshmi për punët e përfunduara).

Sa i përket kandidatit të kontraktuar në pozitën e profesionistit të fushës për ekonomi, sipas CV-së që i njëjti ka ofruar, ai ka punuar vetëm në pozitën e zyrtarit financiar dhe punët që ai ka kryer janë të tilla si punë administrative dhe menaxhim i financave të zyrës. Gjithashtu, metodologjia e punës që kandidati ka ofruar është e formës së letrës së motivimit në të cilën vetëm ka cekur se do t'i kryejë me rend punët e paraqitura tek përshkrimi i punëve në dosje të tenderit. Megjithatë, ai është vlerësuar nga komisioni vlerësues me pikët maksimale si te nënkriteri i përvojës e gjithashtu edhe për metodologjinë e punës. Kandidati tjetër i kontraktuar për të njëjtën pozitë, ka përvojë pune në një fushë tjetër nga ajo se çfarë kërkohet. Kandidati ka përfunduar studimet bachelor në menaxhment dhe informatikë, dhe përvoja e tij e vetme është si agjent i shitjes në disa kompani distributore të shërbimeve ushqimore si dhe zyrtar i sigurisë në një kompani të ndërtimit.

Mangësi të tilla rreth përvojës së punës, vërehen edhe te kandidatët e rekomanduar për kontratë për pozitën profesionist i fushës për juridik. Kandidati i parë sipas të dhënave të ofruara, përveç disa praktikave të përfunduara në gjykatë dhe në komunë, ka punuar për pak kohë edhe në një kompani si zyrtar ligjor dhe sipas referencës së ofruar nga e njëjta kompani, shihet se aty ka kryer punë juridike si përpilim të akteve të ndryshme dhe përpilim të kontratave, e gjithashtu punë administrative. Prandaj këto nuk mund të llogariten përvojë që i kontraktuari të cilësohet si ekspert i një fushe specifike për t'u angazhuar me MShV, ashtu siç e përcakton Rregullorja për Prokurim Publik.

⁴ E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 210-24-36-2-2-1.

Kandidati tjetër për pozitën e njëjtë, në ofertën e tij nuk ka dorëzuar fare CV. Në bazë të kontratës së punës së kaluar, shihet se ai ka punuar në një kompani distributore si menaxher i produktit, si dhe ka përfunduar një praktikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) që nuk ndërlidhet fare me fushën juridike.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) në nëntor të vitit 2023 ka publikuar tenderin “Angazhimi i një eksperti ndërkombëtar dhe një eksperti vendor për finalizimin e Strategjisë Kombëtare për Investime (Politika Kombëtare për Investime) dhe Planit të Veprimit me Kostim”⁵, në kohëzgjatje prej 85 ditë pune për ekspertin ndërkombëtar dhe 100 ditë pune për ekspertin vendor. Tenderi në fjalë është i ndarë në dy lloje.

Parregullsitë në këtë tender nisin nga titulli i tenderit për pozitën “ekspert ndërkombëtar” për shkak se angazhimi i një eksperti ndërkombëtar në hartimin e strategjisë bie ndesh me Ligjin për Prokurim Publik i cilit i ndalon autoriteteve kontraktuese në krijimin e rrethanave ose kushteve të cilat rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. Tutje, LPP i ndalon AK-së të kërkojë operator ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik”⁶. Kërkesa për “ekspert ndërkombëtar” dhe jo “ekspert me përvojë ndërkombëtare” është diskriminuese ngase që në fillim ka diskualifikuar ekspertët vendor me përvojë relevante ndërkombëtare nga aplikimi në këtë tender. Përmes kësaj procedure të prokurimit është kontraktuar një ekspert ndërkombëtar me vlerë të kontratës prej 74,900.00 euro për 85 ditë pune.

Po ashtu, për kandidatin e rekomanduar për kontratë nuk është hera e parë angazhimi në MINT. Kandidati është kontraktuar edhe më herët përmes MShV-ve në tenderin “Angazhimi i një eksperti ndërkombëtar dhe një eksperti vendor për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Industrisë dhe mbështetje të biznesit (Politika Industriale)”⁷. Kjo ka qenë kontratë e nënshkruar në dhjetor të vitit 2021, me vlerë prej 44,910.00 euro dhe kohëzgjatje prej 50 ditë pune. Përveç kësaj, ai është angazhuar përsëri përmes tenderit “Angazhimi i një eksperti ndërkombëtar për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Industrisë dhe përkrahje të biznesit, pjesa 2”⁸, kontratë kjo e nënshkruar në gusht të vitit 2022, me vlerë prej 19,660.00 euro dhe kohëzgjatje prej 20 ditëve të punës. Njësoj edhe në dy rastet e mëparshme Ministria ka kufizuar konkurrencën duke i titulluar tenderët “Angazhimi i një eksperti ndërkombëtar”.

Përveç kësaj, në raportin e vlerësimit të komisionit vlerësues për ofertat e pranuar, komisioni ka vlerësuar me “Në pajtim” edhe dokumentet për pozitën e ekspertit vendor apo llot 2. Mirëpo në E-prokurimi, MINT ka publikuar dokumentin “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, përmes së cilit njofton që aktiviteti i prokurimit për llot 2 është anuluar për shkak se nuk ka pasë asnjë ofertues.

5 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 204-23-13011-2-2-1.

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Neni 7, pika 4 dhe 5.

7 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 204-21-8979-2-2-1.

8 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 204-22-5666-2-2-1.

Angazhimi i ekspertëve për punë teknike-administrative sipas nevojave të institucionit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në maj të vitit 2024 ka nisur procedurat për lidhjen e kontratës “Angazhimi i stafit për nevojat e MKRS-së – koordinator/e për zhvillim të sportit për të gjithë”⁹, të ndarë në dy lloje për dy konsulentë. Njëri konsulent në pozitën e Koordinatorit/es për zhvillim të “sportit për të gjithë” dhe tjetri në pozitën e koordinatorit/es për zhvillim të “mjekësisë sportive” dhe “antidopingut”. Vlera e parashikuar e tenderit është 30,000.00 euro me kohëzgjatje prej 12 muajve.

Pas analizimit të dosjes së tenderit, procesi shihet se ka disa mangësi, si në vijim: 1) afati kohor për dorëzimin e ofertave nuk është respektuar sipas Ligjit për Prokurim Publik, 2) kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë nuk përkojnë me kriteret e përcaktuara në Rregulloren për Prokurim Publik, 3) vlerësimi i ofertave për kriteret që janë kërkuar, nuk është bërë sipas Rregullores për Prokurim Publik, 4) titulli i vendit të punës së konsulentit nuk përkon me kërkesën e Rregullores për Prokurim Publik.

Sa i përket pikës së parë, në bazë të vlerës së parashikuar të kontratës, ky tender bën pjesë te kontratat me vlerë të mesme dhe afati kohor minimal për dorëzim të ofertave duhet të jetë më së paku 20 ditë. MKRS ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 29.05.2024, ndërsa afati i fundit për dorëzim të ofertave është përcaktuar të jetë 13.06.2024, pra në total 15 ditë. LPP, respektivisht neni 46 specifikon qartë rregullat e posaçme për mundësinë e shkurtimeve të afateve kohore dhe shkurtimeve të afateve mund të ndodhë vetëm në rastet të cilat parashihen në këtë nen¹⁰. Në këtë rast, MKRS ka reduktuar afatin kohor pa ofruar shpjegime të mëtijshme, një veprim që ka kufizuar kohën në dispozicion për palët e interesuara për përgatitjen e ofertave të tyre. Si rezultat, numri i ofertuesve për këtë tender ka qenë tejet i ulët: për lotin 1 kanë aplikuar vetëm dy kandidatë, ndërsa për lotin 2 ka aplikuar vetëm një kandidat, i cili më pas është shpërblyer me kontratë.

Sa i përket pikës së dytë, sipas Rregullores për Prokurim Publik, kriteret të cilat duhet patjetër të mirren parasysh për t’i vlerësuar propozimet teknike janë: 1) përvoja përkatëse e këshilltarit, 2) cilësia e metodologjisë së propozuar, 3) kualifikimi dhe 4) transferimi i dijenisë (opsionale). Përkundër kësaj, MKRS në dosjen e tenderit te kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ka kërkuar nga ofertuesit të dorëzojnë: 1) CV me referencat e punës të cilat mbulojnë përvojën përkatëse, 2) diplomat të cilat mbulojnë pjesën e kualifikimit 3) oferta financiare dhe 4) letra e motivimit. Pra, siç shihet nga tabela në vijim, MKRS nuk ka kërkuar metodologjinë e punës e as transferimin e dijenisë (edhe pse kjo e fundit opsionale).

⁹ E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 207-24-5354-2-1-1.

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Neni 35, pika 4 dhe 5.

Kriteret sipas Rregullores për Prokurim Publik

Kriteret e vlerësuar nga Ministria

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit	1	CV, Referencat për përvojën e punës
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar	2	✘
3	Kualifikimi	3	Diplomat / Certifikimet
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet	4	✘
		5	Oferta financiare, Letra e motivimit
		6	Intervista

Sa i përket pikës së tretë apo vlerësimit të bërë nga MKRS për kriteret e kërkuara, në vend që dokumentet e kërkuara të vlerësohen/peshohen me pikët të cilat janë të përcaktuara në Rregullore, ato janë përmbledhur si një grup dhe janë vlerësuar me “Në pajtim” ose “Nuk është në pajtim”. Pas kësaj, është paraqitur edhe një tabelë me pikët përfundimtare të tre aplikuesve, mirëpo nuk dihet se me sa pikë është vlerësuar secili dokument dhe si është arritur te rezultati përfundimtar.

Parregullsi janë vërejtur edhe te titulli i vendeve të punës për konsulentët. Sipas Rregullores për Prokurim Publik, konsulenti individual është një specialist i një fushe specifike, i angazhuar nga autoriteti kontraktues në rolin e një këshilluesi, gjithashtu kryen shërbime profesionale për të cilat autoriteti kontraktues ka nevojë por nuk mund t'i plotësojë me stafin që ka¹¹. Sipas përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive në dosjen e tenderit për llot 1, punët si: koordinimi i procesit të zbatimit të projekteve shtetërore, menaxhimi i grupeve punuese, komunikimi me institucione publike, monitorimi i zbatimit të planeve të projekteve dhe shkrimi i raporteve, nuk janë shërbime të veçanta ose specifike mirëpo janë punë teknike-administrative të cilat mund të mbulohen nga stafi aktual i MKRS-së. Njëjtë edhe për llot 2 ku punët si hartimi i planeve të veprimit për

secilin program, monitorimi i mbarëvajtjes së zbatimit të planeve, komunikimi me institucionet dhe organizatat relevante, ato nuk janë punë të shërbimeve të veçanta ku kërkohet ekspertizë specifike mirëpo janë punë të rëndomta teknike-administrative të cilat mund të mbulohen me stafin aktual të Ministrisë. Kjo sidomos duke marrë parasysh që në këtë departament, përveç drejtorit, e tre udhëheqësve të divizioneve, janë të punësuar edhe 18 persona tjerë¹².

Sidoqoftë, MKRS ka nënshkruar kontratë me dy kandidatët e përzgjedhur për 12 muaj, në vlerë prej 15,000.00 euro për secilin llot (30,000.00 gjithsej), që i bie se të dy konsulentët do të paguheshin me 1,250.00 euro për muaj për një vit.

11 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Rregullore e prokurimit publik 001/2022, neni 57.3 dhe 57.4, 2022. https://eprokurimi.rksgov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

12 Uebfaqja zyrtare e MKRS-së, Departamenti i Sportit, 2024. <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,49> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në qershor 2024 ka publikuar “Njoftimin për Kontratë për tenderin tjetër “Angazhimi i konsulentëve për nevojat e MKRS-së dhe institucioneve vartëse”¹³, të ndarë në pesë (5) lloje. MKRS përmes këtij tenderi ka planifikuar të angazhojë pesë ekspertë në fushat si: 1) ekspert i lartë i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, 2) konsulent të fotografisë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, 3) konsulent për marrëdhënie me publikun dhe 4) dy ekspertë në fushën e sportit. Vlera e parashikuar për tenderin në fjalë është përcaktuar të jetë 71,580.00 euro, me një afat kohor prej gjashtë, dymbëdhjetë dhe tridhjetë e gjashtë muaj, varësisht prej llotit.

Pas analizimit të dosjes së tenderit, vërehet se procesi ka pasur disa parregullsi: 1) afati kohor për dorëzimin e ofertave nuk është respektuar sipas Ligjit për Prokurim Publik; 2) kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara

me Rregulloren për Prokurim Publik; 3) titulli i vendit të punës së konsulentit nuk përkon me kërkesën e Rregullores së Prokurimit Publik 4) vlerësimi i ofertave edhe për ato kritere që janë kërkuar nuk është bërë sipas Rregullores për Prokurim Publik.

Sa i përket pikës së parë, tenderi në fjalë bën pjesë të kontratat me vlerë të mesme, prandaj edhe afati kohor për pranimin e ofertave sipas Ligjit për Prokurim Publik do të duhej të ishte jo më pak se 20 ditë, e jo 10 ditë ashtu siç është përcaktuar në dosjen e tenderit, pa ndonjë sqarim shtesë. Rrjedhimisht, duke mos lënë afat kohor të mjaftueshëm për informim dhe aplikim, në të gjitha llotet e paraqitura në dosje të tenderit ka pasë vetëm nga një ofertues, të cilët sipas MKRS-së i kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara dhe të gjithë janë shpërblyer me kontratë. Kjo përveç llotit 3 - konsulent për marrëdhënie me publikun, i cili është anuluar pasi që nuk ka pasur asnjë ofertues.

Sa i përket pikës së dytë, më poshtë janë paraqitur kriteret që kërkohen përmes Rregullores për vlerësim teknik të ofertave si dhe kriteret që janë kërkuar nga Ministria për tenderin në fjalë:

Kriteret sipas Rregullores për Prokurim Publik

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar
3	Kualifikimi
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet

Kriteret e vlerësuara nga Ministria

1	CV Referencat për përvojën e punës (të ndryshme varësisht prej llotit)
2	✗
3	Diplomat / Certifikimet
4	✗
5	Oferta financiare
6	Intervista

13 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 207-24-8728-2-2-1.

Siç vërehet në tabelë, MKRS ka vlerësuar ofertat sipas nënkritereve që nuk do të duhej të përfshiheshin si kritere dhe nuk ka kërkuar nga ofertuesit që të dorëzojnë metodologji të punës e cila është kriter sipas Rregullores për Prokurim Publik.

Sa i përket pozitave apo titujve të vendeve të punës për çka janë kontraktuar konsulentët, ato nuk përkojnë me Rregulloren për Prokurim Publik, pasi që sipas kësaj Rregulloreje konsulentët duhet të angazhohen vetëm në rastet kur autoritetit kontraktues i duhet një ekspert i një fushe specifike dhe këtë shërbim nuk mund ta plotësojë me stafin që e ka. Në vijim sqarohen detajet e përzgjedhjes së kandidatëve dhe informata në lidhje me pozitat për të cilat ata janë punësuar.

Kandidati i kontraktuar për lot 1 (ekspert i lartë i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta) ka ofertuar duke dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, me përjashtim të metodologjisë së punës. Megjithatë, sipas CV-së së dorëzuar nga kandidati, vërehet se ka punuar si Drejtor në Zyrën e të Drejtave të Autorit në MKRS për mbi shtatë vite, konkretisht deri në qershor të vitit 2021. Para kësaj, ai gjithashtu ka qenë Zyrtar i Lartë Ligjor në Zyrën e të Drejtave të Autorit në po të njëjtën Ministri. Aktualisht në këtë Zyre janë të punësuar Drejtori dhe 3 zyrtarë të tjerë¹⁴. I kontraktuari si ekspert i lartë i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta ka nënshkruar kontratë me MKRS në vlerë prej 5,220.00 euro, për një periudhë kohore gjashtë mujore.

Kandidati i përzgjedhur për lot 2 (konsulent i fotografisë në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit), sipas CV-së, ka qenë gjithashtu i angazhuar në MKRS përmes MShV nga viti 2022 deri në korrik të vitit 2024. Menjëherë pas përfundimit të kontratës, MKRS ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin në fjalë, përmes së cilit është angazhuar përsëri dhe ka nënshkruar kontratë me 25 shtator 2024, me vlerë prej 10,800.00 euro, në kohëzgjatje prej 12 muajve. Në këtë rast, MShV është përdorë për zgjatjen e afatit të punës. I kontraktuari edhe në kontratën e mëparshme ka qenë i angazhuar në Divizionin për Komu-

nikim Publik në pozitën e njëjtë. Ky Divizion ka të punësuar udhëheqësin si dhe dy zyrtarë tjerë të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të rregulluara me Rregulloren për Komunikim Qeveritar me Publikun¹⁵. Sipas kësaj Rregulloreje, funksionet e Zyrës për Komunikim me Publikun përveç tjerash janë edhe përgatitja, shpërndarja dhe arkivimi i fotografive dhe materialeve audio-vizuele të aktiviteteve kryesore të Ministrisë.¹⁶ Në këtë rast, vërehet se konsulenti është angazhuar për të kryer punë të përditshme dhe jo ofrimin e shërbimit të veçantë apo ekspertizë specifike për çka mund të përdoren MShV.

Për lot 4 dhe 5 (dy ekspertë në fushën e sportit) kanë nënshkruar kontratë me vlerë prej 24,480.00 euro secili llot, dhe kohëzgjatje prej 36 muajve. Sikur në rastet më lartë, të dy kandidatët e kontraktuar sipas referencave të përcjellura përmes ofertave të tyre kanë qenë të angazhuar edhe me herët në këtë Ministri. Fillimisht ata kanë filluar praktikën me 21.03.2022 deri më 31.03.2023 e pas kësaj janë angazhuar në të njëjtën Ministri dhe departament nga data 01.08.2023 deri më 01.07.2024. Sikurse edhe në rastet mësipërme, menjëherë pas skadimit të kësaj kontrate, të njëjtët janë kontraktuar nga data 25.09.2024, për një periudhë kohore prej 36 muajve. Sipas përshkrimit të punëve në Aneksin 1 për pozitat në fjalë, kryerja e detyrave sipas planeve të punës, udhëheqja e grupeve punuese kur kërkohet, këshillimi i safit të nivelit më të ulët, komunikimi me autoritetet e jashtme, nuk janë asnjëra shërbime të veçanta apo specifike që nuk do të mund të mbuloreshin nga stafi aktual në departamentin përkatës.

Sa i përket vlerësimit të ofertave sipas kritereve të vendosura nga Ministria, nuk ka ndodhur sipas kërkesës së Rregullores për Prokurim Publik. Duke qenë se Rregullorja përcakton saktësisht se sa mund të vlerësohet secili kriter teknik dhe në fund ai financiar, në raportin e vlerësimit të ofertuesve shihet se të gjitha dokumentet janë grumbulluar në një kriter të vetëm dhe janë vlerësuar "Në pajtim" ose "Nuk është në pajtim". Pra, kriteret e vlerësuar nuk janë peshuar një nga një mirëpo përmes një tablele ku shihet rezultati i vlerësimit me pikë të caktuara, por nuk dihet se si kanë arritur te ato pikë.

¹⁴ Uebfaqja zyrtare e MKRS-së, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, 2024. <https://www.mkrs-ks.org/?page=1.159> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

¹⁵ Uebfaqja zyrtare e MKRS-së, Sekretari i përgjithshëm, Divizioni për Komunikim Publik, 2024. <https://www.mkrs-ks.org/?page=1.100> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Rregullore (QRK) NR. 27/2018 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, neni 10, pika 1.6, 2019.

Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit në prill të 2024 ka nisur procedurat për lidhjen e kontratës me qëllim “Ofrimi i shërbimeve konsulente nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta (konsulent individë) - monitorues të projekteve të subvencioneve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, tri pozita”¹⁷ të ndarë në tri lloje për tre konsulentë. Secili konsulent për një fushë, si në vijim: konsulent-monitorues i subvencioneve në fushën e kulturës, konsulent-monitorues i subvencioneve në fushën e rinisë dhe konsulent-monitorues i subvencioneve në fushën e sportit.

Në bazë të analizimit të dosjes së tenderit, procesi ka parregullsitë si në vijim: 1) titulli i vendit të punës nuk përkon me kërkesën e Rregullores së prokurimit publik; 2) kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me Rregulloren për prokurim publik; dhe 3) vlerësimi i ofertave edhe për ato kritere që janë kërkuar nuk është bërë sipas Rregullores për Prokurim Publik.

Sa i përket pikës së parë, Rregullorja për prokurim publik përcakton që konsulenti është një specialist në një

fushë specifike dhe angazhohet në rolin e një këshilluesi. Po ashtu, konsulenti kryen shërbime të veçanta, pra që nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik, pra nuk janë punë të zakonshme teknike-administrative. Sipas kësaj, del se monitorimi i subvencioneve në fushën e kulturës, rinisë apo sportit nuk është shërbim i veçantë apo specifik që nuk do të mund të mbulohej nga stafi aktual në drejtorinë përkatëse në komunë. Po ashtu, monitorimi si punë nuk është punë këshilluese, ku tek pika III.2.4. – kapaciteti teknik dhe profesional – definohet që kriteret bazë për konsulentë janë “shqyrtimi i aplikacioneve dhe rekomandimi për subvencionim në fushën e kulturës, rinisë apo sportit”. Pra, shqyrtimi i aplikacioneve si rezultat rekomandimit për përfitim nga subvencionimi, nuk janë punë këshilluese, por punë teknike-administrative të cilat nuk lidhen me profilin e një këshilluesi.

Sa i përket pikës së dytë, kriteret që kërkohet të vlerësohen me Rregulloren e Prokurimit Publik, ato nuk janë përfillur nga komuna e Prizrenit në rastin e njoftimit për kontratë. Shih në vijim se çka kërkohet nga Rregullorja në kuptim të kriterëve dhe çka është kërkuar nga komuna e Prizrenit.

Kriteret sipas Rregullores për Prokurim Publik

Kriteret e vlerësuara nga Komuna

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit	1	CV Referencat për përvojën e punës
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar	2	✗
3	Kualifikimi	3	Diplomat / Certifikimet
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet	4	✗

17 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 622-24-4195-2-2-1.

Sipas kësaj tabele, komuna nuk ka kërkuar dokument për vërtetimin e kriterit të dytë, metodologji të propozuar nga ana e aplikuesit. Pra, në këtë aspekt, është dashur të kërkohej një metodologji se si konsulenti do të bëjë monitorimin apo edhe shqyrtimin e aplikacioneve, pra në bazë të të cilave kritere do të bëjë monitorimin. Po ashtu, kriteri i transferimit të njohurisë, edhe pse jo obligativ në rregullore, nuk është vlerësuar i nevojshëm të kërkohej edhe pse kjo është një punë që njohuritë për të mund të transferohen tek stafi ekzistues.

Sa i përket pikës së tretë, vlerësimi i ofertave sipas kriterëve të vendosura nga komuna, nuk ka ndodhur sipas kërkesës së Rregullores për Prokurim Publik. Kjo sepse Rregullorja kërkon që të peshohet secili kriter sipas pikëve të përcaktuara me rregullore, për shembull "kualifikimi" ka peshën prej 20 deri 40 pikë, metodologjia apo plani i punës peshohet me 20 deri 50 pikë dhe përvoja specifike peshohet nga 20 deri 50 pikë. Në bazë të raportit të vlerësimit ofruar nga komuna e Prizrenit, vlerësimi është bërë për grup të kriterëve sipas dokumenteve të kërkuara, dhe një nga një për dokumentet e kërkuara, mirëpo pa dhënë pikë. Për shembull, tek vlerësimi si grup për katër oferta, vlerësimi është dhënë me "I papajtueshëm" ose "Në pajtim" por nuk ka pikë. Pastaj, kur janë vlerësuar një nga një dokumentet, në vlerësim nuk tregohet se cili dokument është duke u vlerësuar sepse tek emri i dokumentit, shkruan N/A. Pra, nuk dihet se si janë shpërndarë pikët për vlerësimin e dokumenteve të kërkuara nga kandidatët.

Përveç kësaj, sa i përket përvojës specifike të punës dhe kualifikimit që janë dorëzuar nga kandidatët, ato nuk janë në përputhje me natyrën e punëve që janë zgjedhur të kryejnë. Për shembull, kandidati i zgjedhur si monitorues i projekteve të subvencioneve në fushën e kulturës ka përvojë pune si menaxher dhe arkatar në supermarket, pastaj agjent i shitjes në një lulishte, kurse si përgatitje profesionale ka Bachelor i Shkencave në Agrobiznes. Kjo bie në kundërshtim me kërkesat e Rregullores për prokurim publik ngase kjo kërkon që përvoja e punës të jetë specifike për shërbimin që do të kryhet e natyrshëm edhe kualifikimi duhet të jetë adekuat. Pastaj, kandidati i zgjedhur si monitorues i projekteve të subvencioneve në fushën e rinisë ka përvojë pune dy vjeçare në një ofrues privat të shërbimeve të telekomunikimit, ka praktikë pune gjashtë muaj në

një kompani të sigurimit e pastaj edhe një praktikë tjetër tre mujore si zyrtar ligjor. Sa i përket shkollimit, kandidati është i diplomuar në fakultetin ekonomik – specializimi në financa, banka dhe sigurime. Pra, këto janë në kundërshtim me kërkesat apo kriteret e Rregullores për Prokurim Publik sa i përket përvojës specifike të punës dhe kualifikimit të cilat duhet natyrshëm të lidhën me punën që do të kryen i përzgjedhuri. Kandidati i tretë i përzgjedhur për monitorues të projekteve të subvencioneve në fushën e sportit, ka praktikë pune në një institucion publik, ka punuar si receptionist hoteli dhe ka qenë trajner futbollit. Sa i përket shkollimit, ka kryer fakultetin në marrëdhënie ndërkombëtare e pastaj edhe në menaxhimin e sportit. Edhe pse këto nuk janë adekuate për qëllimin për të cilin ka aplikuar, prap është më afër natyrës së punës – subvencionet në fushën e sportit – se sa kandidatët e tjerë.

Megjithatë, pavarësisht të gjitha rrethanave të përmendura, Komuna e Prizrenit ka nënshkruar kontrata me të tre kandidatët e përmendur më sipër për një periudhë prej 36 muajsh, me një vlerë totale prej 48,474 euro, që përkthehet në rreth 450 euro në muaj për secilin konsulent. Këto kontrata janë të vlefshme deri më 17 qershor 2027. Si përfundim, mund të konstatohet se të tre konsulentët janë angazhuar për një periudhë tre vjeçare me një pagë standarde në shërbimin civil, për kryerjen e detyrave tekniko-administrative të zakonshme, në shërbim të nevojave të Drejtorisë për Kulturë në Komunën e Prizrenit.

Komuna e Pejës

Komuna e Pejës në maj 2024 ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin “Shërbime Konsulente Individuale për nevojat e Komunës së Pejës”¹⁸ të ndarë në 6 lote. Përmes këtij tenderi komuna ka planifikuar të angazhojë gjashtë konsulentë individual për pozitat si: 1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (2 pozita), 2) inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (1 pozitë), 3) inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose MA i arkitekturës (3 pozita). Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 140,400.00 euro, me kohëzgjatje prej 36 muajsh. Ofertuesit sipas dosjes së tenderit, kanë pasur mundësinë që të aplikojnë në të gjitha llotet, mirëpo të shpërblehen vetëm me një.

Pas analizimit të dosjes së tenderit vërehet se ka pasur disa parregullsi në procesin e prokurimit si në vijim: 1) kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Prokurim Publik, 2) shfrytëzimi i MShV-ve për zgjatjen e afatit të punës, 3) mos respektimi i Rregullores për krijimin e komisionit vlerësues të tenderit, 4) mos respektimi i procedurës së prokurimit për shërbime të veçanta.

Sipas pikës së parë, përcaktimi kërkesave si kritere vlerësuese nuk është në përputhje me Rregulloren për Prokurim Publik për shkak se nuk ka kërkuar nga ofertuesit të dorëzojnë metodologjinë e punës i cili është kriteri kryesor në vlerësim.

Kriteret sipas Rregullores për Prokurim Publik

Kriteret e vlerësuara nga Komuna

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit	1	CV Referencat për përvojën e punës
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar	2	✘
3	Kualifikimi	3	Diplomat
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet	4	✘

¹⁸ E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 635-24-4277-2-1-1.

Kandidati i kontraktuar për lot 1 (Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë), ka nënshkruar kontratë me datë 22.07.2024, me vlerë prej 23,040.00 euro, me kohëzgjatje prej 36 muajve. I njëjti konsulent është kontraktuar edhe në vitin 2021, me kohëzgjatje prej 36 muajve. Kjo do të thotë që konsulenti ka përfunduar kontratën me komunën e Pejës me 27.06.2024 dhe menjëherë ka filluar punën me kontratën tjetër. Në këtë rast, komuna ka shfrytëzuar MShV-të për vazhdimin e afatit të punës (shërbimit) për të njëjtin konsulent. I njëjti rast paraqitet edhe te kontraktimi i kandidatit për lot 4 (Inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose Master i arkitekturës), i cili ka qenë i kontraktuar nga komuna e Pejës me po të njëjtën kontratë edhe në vitin 2021 me kohëzgjatje prej 36 muajve.

Përveç kësaj, njëri nga anëtarët e përcaktuar në komisionin vlerësues për tenderin në fjalë ka qenë gjithashtu i kontraktuar përmes MShV-ve në vitin 2021 si Inxhinier i arkitekturës dhe se vlerësimi i ofertuesve nga ky komision është bërë në kohën kur anëtari i komisionit vlerësues ka qenë i angazhuar në komunë me kontratë të MShV (11.06.2024). Rregullorja e prokurimit publik përcakton që: *“AK ka të drejtë të angazhojë ekspert të jashtëm, në rastet kur kërkohet njohuri dhe ekspertizë e veçantë teknike ose e specializuar varësisht nga objekti i prokurimit dhe që ekspert të tillë nuk janë në dispozicion brenda AK. Ekspertët e tillë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP-së njejtë si anëtarët e komisionit të vlerësimit nga AK”*¹⁹. Prandaj, mënyra e përcaktimit të tij si anëtar i komisionit nuk është e lejuar për shkak se ai ka qenë i angazhuar si ekspert me një tjetër MShV dhe nuk është kontraktuar specifikisht për të marrë pjesë në komision të vlerësimit ashtu siç është e rregulluar edhe me Ligj.

Në këtë tender ka pasur edhe mos respektim të procedurës së tenderimit ngase kandidati i kontraktuar për lot 5 (Inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose Master i arkitekturës), është vlerësuar si biznes e jo si person fizik. Të gjitha dokumentet e ofruara janë në emër të kandidatit si person fizik, si: CV, diploma, referencat, mirëpo në vendimet dhe raportet e komunës, figuron emri i biznesit, e pastaj në vazhdimësi emri i kandidatit. Sipas Rregullores për Prokurim Publik, për shërbime të veçanta mund të oftojnë vetëm personat fizik nga të cilët nuk kërkohet të kenë biznes të regjistruar mirëpo të jenë të regjistruar në e-prokurimi si person fizik²⁰.

Përveç pikave të cekura më sipër, sa i përket përvojës specifike të punës dhe kualifikimit që janë dorëzuar nga kandidatët, ato nuk janë në përputhje me natyrën e punëve që janë zgjedhur të kryejnë. P.sh. kandidati i kontraktuar për lot 2 për pozitën Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, ka nënshkruar kontratë në vlerë prej 23,400.00 euro dhe kohëzgjatje prej 36 muajsh. Kandidati në fjalë ka diplomuar në vitin 2022 dhe si referencë pune ka ofruar disa praktika të përfunduara para periudhës së diplomimit. Ndërsa, nëse analizojmë përvojën profesionale të kandidatit pas diplomimit nga viti 2022, referencat e ofruara tregojnë se në total kandidati ka vetëm 17 muaj përvojë pune. Kjo tregon se nuk bëhet fjalë për një ekspert, siç kërkohet edhe nga Rregullorja për lidhjen e kontratave përmes MShV-ve.

¹⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 39, pika 9. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

²⁰ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 57.5, 2022. https://eprokurimi.rksgov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

Angazhimi i ekspertëve për shërbime të IT-së

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në korrik 2024 ka publikuar “Njoftimin për kontratë per tenderin: “Angazhimi i një kontraktori individual për ekspertizë të IT në mirëmbajtjen dhe përditësimin e web faqes”²¹. Vlera e parashikuar për këtë tender është 8,900.00 euro me kohëzgjatje prej 12 muajve.

Përmes këtij tenderi, MASHTI ka planifikuar të angazhojë një kontraktor individual duke shfrytëzuar MShV-të, të cilat janë të parapara që të përdoren në rastet kur një autoriteti kontraktues i nevojitet një konsulent ekspert i një fushe ose profesioni të caktuar. Sipas analizimit të dosjes së tenderit, parregullsitë e gjetura në procesin e prokurimit janë: 1) kriteret e ven-

dosura në njoftimin për kontratë nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Prokurim Publik dhe 2) titulli i vendit të punës së konsulentit nuk përkon me kërkesën e Rregullores së Prokurimit Publik.

Sa i përket pikës së parë, kërkesat e përcaktuara nga MASHTI për kontraktim të ekspertit kanë qenë si: diploma, CV, përvojë pesë vjeçare në IT (e dëshmuar me referenca), njohuri në fushën e rrjeteve sociale (të dëshmuar) si dhe letra e motivimit. Kandidati i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara, përveç dëshmisë për njohuri të rrjeteve sociale. Ai ka dorëzuar dy certifikata për trajnime të përfunduara në fushën e IT-së, mirëpo të dyja i takojnë fushave tjera dhe jo asaj që është kërkuar. Gjithashtu, nga MASHTI nuk është kërkuar fare metodologjia e punës e cila sipas Rregullores do të duhej të përdorej për vlerësim teknik të ofertës duke e peshuar me pikët që janë të përcaktuara në Rregullore.

Kriteret sipas Rregullores për Prokurim Publik

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar
3	Kualifikimi
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet

Kriteret e vlerësuara nga Ministria

1	CV Referencat për përvojën e punës
2	✘
3	Diplomat
4	✘
5	Letra e motivimit
6	Oferta financiare

²¹ E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 208 Udhëheqësi-24-7291-2-3-6.

Ajo çka vlen të theksohet është përvoja e kandidatit të kontraktuar. Sipas CV-së së dorëzuar në ofertë së bashku me pjesën tjetër të dokumenteve, shihet se ai ka qenë i angazhuar në këtë Ministri nga viti 2018 deri në vitin 2021. Ndërsa sipas referencave të lëshuara nga zyrtarët e Ministrisë, kandidati ka qenë i angazhuar në këtë Ministri nga viti 2018 deri më 30 maj të vitit 2024. Përgjatë kësaj kohe i njëjti është angazhuar si ekspert i IT-së në mirëmbajtjen dhe përditësimin e web faqes dhe rrjeteve sociale të MASHTI-t, në kuadër të Divizionit për Komunikim Publik. Kjo do të thotë që MShV në këtë rast është shfrytëzuar për vazhdimin e afatit të punës (shërbimit) për personin në fjalë, andaj²² MASHTI ka angazhuar të njëjtin person përmes disa tenderëve nga viti 2018 deri në vitin 2024 dhe sipas kësaj, kandidati i kontraktuar ka bërë mbi gjashtë vite angazhim përmes MShV-ve në këtë ministri.

Sa i përket detyrave që kandidati i rekomanduar për kontratë duhet të kryej, shihet se ka të njëjtat obligime të paraqitura te përshkrimi i punëve sikurse edhe në tenderët e kaluar, si: publikimin e komunikatave, njoftimeve, vendimeve etj në webfaqen e MASHTI-it, do të ndërhyjë në webfaqe për të përmirësuar qasjen, sigurinë, strukturimin e materialeve, menaxhimin e rrjeteve sociale, ndihmë në arkivimin e artikujve, fotografive, etj. Siç shihet, këto detyra nuk janë shumë punë specifike apo shërbim i veçantë për të cilat duhet të angazhohet një ekspert përmes MShV-ve, ashtu siç e lejon edhe legjislacioni për prokurim publik. Për më tepër, sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MASHTI, shihet se në Departamentin për Punë të Përgjithshme ekziston Divizioni i IT-së, Administrimit të Dokumenteve dhe Shërbimeve. Në këtë Divizion janë të punësuar dy zyrtarë të lartë për administrimin e teknologjisë informative. Përveç kësaj, ekziston edhe Divizioni për Komunikim me Publikun në të cilin punon një zyrtar për multimedia dhe webfaqe, detyrë e së cilit përveç tjerash është mirëmbajtja dhe përditësimi i webfaqes së Ministrisë si dhe ofrimi i trajnimeve për stafin e MASHTI-t për përdorimin e webfaqës²³.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në qershor të vitit 2024 ka nisur procedurat për tenderin “Angazhimi i dy konsulentëve - kontraktorëve individual për shërbime të veçanta në sektorin e Teknologjisë Informative”²⁴. Ky tender është ndarë në dy lloje, me vlerë totale të parashikuar prej 50,400.00 euro, secili lloj nga 25,200.00 euro për një periudhë kohore prej 36 muajve.

Pas analizimit të dosjes së tenderit, në procesin e zhvillimit të tij janë vërejtur disa parregullsi të cilat janë si në vijim: 1) përcaktimi i kriterëve për vlerësimin teknik të propozimeve, nuk janë të vendosura siç duhet, 2) vlerësimi i ofertave për kriteret që janë kërkuar nuk është bërë sipas Rregullores për Prokurim Publik, 3) titulli i vendit të punës së konsulentit nuk përkon me Rregulloren për Prokurim Publik.

Sa i përket përcaktimit të kriterëve për vlerësim teknik të propozimeve, sipas Rregullores për Prokurim Publik, janë: 1) përvoja përkatëse, 2) metodologjia e planit të punës, 3) kualifikimi si dhe 4) transferimi i njohurisë si kriter opsional. Pikët totale të vlerësimit të një propozimi arrihen duke bashkuar pikët teknike dhe ato financiare. Rezultati i vlerësimit financiar duhet të peshohet me më së shumti 30 pikë.

Në këtë rast, AUV për vlerësim teknik ka vendosur kriteret si përvoja, metodologjia e kualifikimi, mirëpo si kriter ka shtuar edhe ofertën financiare, e cila sipas Rregullores do të duhej të përfshihej në fund pasi që të bëhet komplet vlerësimi teknik dhe pastaj ai financiar të bashkohet me atë teknik dhe të peshohet me më së shumti 30 pikë.

22 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Rregullore nr.001/2022 për Prokurim Publik, neni 57.8, 2022. https://eprokurimi.rksgov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

23 MASHT, Rregullore [ZKM] Nr.09/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2024. <https://masht.rks-gov.net/rregullore-zkm-nr-09-2024-per-organizimin-e-brendshem-dhe-sistematizimin-evendeve-te-punes-ne-ministrine-e-arsimit-shkencesteknologjise-dhe-inovacionit/> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

24 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 40800-24-5898-2-2-1.

Kriteret sipas Rregullores për Prokurim Publik

Kriteret e vlerësuar nga AUV

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit	1	CV Referencat për përvojën e punës
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar	2	Metodologjia
3	Kualifikimi	3	Diplomat / Certifikimet
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet	4	✘
		5	Oferta financiare

Përveç përcaktimit të gabueshëm të kriterëve, parregullsi vërehen edhe te mënyra e vlerësimit të ofertave nga komisioni i vlerësimit. AUV ka marrë parasysh kërkesat e përshtatshmërisë profesionale si: diploma universitare e shkencave kompjuterike dhe përvoja e punës së paku një vit, të cilat pastaj janë vlerësuar me “Në pajtim”, ose “Nuk është në pajtim”. Pas kësaj, kanë vlerësuar se cila është oferta më e lirë dhe është vendosur për njërin nga kandidatët. Në raportin e vlerësimit, nuk shihet se me sa pikë është vlerësuar secili kriter si kualifikimi dhe përvoja e punës të cilat janë përcaktuar nga AUV dhe më e rëndësishmja, nuk përmendet askund metodologjia e punës as nëse kandidatët e kanë plotësuar këtë kërkesë dhe as me sa pikë është vlerësuar kriteri në fjalë.

Sa i përket titullit të vendit të punës për konsulentin e përcaktuar, nuk përkon me Rregulloren për Prokurim Publik. Siç është cekur edhe më lartë, titulli konsulent i teknologjisë informative, duke marrë parasysh kërkesat për njohuri në dosjen e tenderit si: konfigurimi dhe arkivimi i email-ave qeveritar, mirëmbajtja e kompjuterëve, njohuri për domainet qeveritare, njohuri në instalimin dhe konfigurimin e printerëve dhe skanerëve, nuk paraqesin kërkesë për një ekspert i cili do të kryente punë që nuk kanë mundësi të kryhen nga zyrtarët e IT-së në AUV. Madje, edhe vetë kërkesa e AUV në këtë rast që ofertuesi t'i ketë së paku një vit përvojë pune, tregon se si mund të konsiderohet ekspert i një fushe të caktuar një person që ka përvojë vetëm një vjeçare.

Sidoqoftë, AUV ka përzgjedhur një kandidat për nënshkrim të kontratës për llot 1, në vlerë prej 22,000.00 euro që i bie se do të paguhet me 611.11 euro për muaj. Ndërsa llot 2 është anuluar përshkak se nuk ka pasur asnjë ofertues.

Komuna e Vitisë

Kuvendi Komunal i Vitisë në korrik të vitit 2024 ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin "Blerja e shërbimeve konsulente për web faqen turistike të komunës"²⁵, në kohëzgjatje prej 24 muajve. Përmes këtij tenderi, komuna ka planifikuar angazhimin e një konsulenti i cili do të bëjë promovimin e komunës si një destinacion tërheqës turistik, ofrimin e informacioneve rreth atraksioneve dhe ngjarjeve që zhvillohen në komunën e Vitisë, rritjen e ndërgjegjësimit për trashëgiminë kulturore dhe historike të Vitisë, etj.

Duke analizuar procesin për tenderin në fjalë janë vërejtur disa parregullsi si në vijim: 1) kriteret e vend-

sura në njoftimin për kontratë nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me Rregulloren për prokurim publik, 2) mos përcaktimi i duhur i termave të referencës siç përcaktohet në Rregullore, 3) mos respektimi i afatit kohor për dorëzim të ofertave, 4) vlerësimi i ofertës edhe për ato kritere që janë kërkuar nuk është bërë sipas Rregullosës për Prokurim Publik.

Pika e parë e cekur më sipër mund të vërehet te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të paraqitura në dosje të tenderit. Komuna ka kërkuar nga ofertuesit të dërgojnë CV, diplomë në gazetari ose fusha të ngjashme, aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe shkrimit në gjuhën shqipe dhe angleze (preferohet edhe gjuha serbe) dhe referenca për vendet e punës.

Kriteret sipas Rregullosës për Prokurim Publik

Kriteret sipas Rregullosës për Prokurim Publik	Kriteret e vlerësuara nga komuna
1 Përvoja përkatëse e këshilltarit	1 CV Referencat për përvojën e punës
2 Cilësia e metodologjisë së propozuar	2 ✘
3 Kualifikimi	3 Diplomat
4 Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet	4 ✘
	5 Oferta financiare

25 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 657-24-7762-2-2-1.

Siç shihet nga tabela më lartë, komuna ka kërkuar dokumente për vlerësim të kritereve që nuk janë në përputhje me kriteret që përcaktohen me Rregulloren e Prokurimit Publik. Si në shumicën e rasteve, komuna nuk ka kërkuar metodologjinë e punës për kandidatët që ofertojnë. Në këtë tender, ka aplikuar vetëm një kandidat i cili ka përmbushur kriteret e komunës ashtu siç janë kërkuar (pa metodologjinë e punës). Mirëpo, titulli i vendit të punës apo detyrat për çka do të angazhohet konsulenti, nuk përkohjnë me kërkesën e Rregullores për Prokurim Publik.

Aspekti i dytë që vlen të përmendet është se në dosje të tenderit ose në kontratën e nënshkruar me kandidatin e kontraktuar nuk përcaktohen raportet që kandidati duhet të dorëzojë, formati i tyre, shpeshësia ose përmbajtja e raporteve. Sipas Rregullores për Prokurim Publik, *“TeR duhet të tregojë kohëzgjatjen e përafërt të detyrës, nga data e fillimit deri te data kur AK merr dhe pranon raportin përfundimtar të konsulentit. TeR duhet të tregojë formatin, shpeshësinë dhe përmbajtjen e raporteve”*²⁶.

Aspekti i tretë i përmendur më sipër lidhet me vlerën e parashikuar të këtij tenderi që ka shpërputhje nga ajo se çka paraqitet në Dosje të Tenderit dhe ajo që paraqitet në Njoftimin për Kontratë. Në njoftim për kontratë është përcaktuar vlera e parashikuar 10,000.00 euro, ndërsa në dosje të tenderit është përcaktuar 9,120.00 euro. Kjo ngatërresë shkakton paqartësi edhe te kandidatët e interesuar për të ofertuar.

Megjithatë, me datë 11 tetor 2023, Kryetari i komunës së Vitisë ka nxjerrë vendim²⁷ për të përcaktuar zyrtarin për bashkëpunim me Swisscontact për zbatimin e memorandumit “Krijimi i brendit turistik dhe promovimit të komunës së Vitisë”. Duke marrë parasysh që projekti ka filluar shumë më herët, Komuna ka pasë kohë të mjaftueshme për publikim të tenderit në fjalë më përpara, në mënyrë që të mos shkurtohet afati dhe t’u ofrohet mundësi të gjithë ofertuesve të interesuar t’i përgatisin ofertat e tyre dhe të aplikojnë.

Sa i përket vlerësimin të ofertave sipas kritereve të vendosura nga komuna, kjo nuk është bërë sipas kërkesës së Rregullores për Prokurim Publik. Kjo sepse Rregullorja kërkon që të peshohet secili kriter sipas pikëve të përcaktuara me Rregulloren, ku duhet të përfshihet patjetër edhe metodologjia e punës. Mirëpo, në raportin e komisionit të vlerësimit të gjitha dokumentet janë grumbulluar në një kriter dhe janë vlerësuar me “Në pajtim”, dhe nuk dihet se me sa pikë është vlerësuar çdo kriter i përcaktuar në dosje të tenderit e rrjedhimisht as nuk dihet se me sa pikë është vlerësuar si në total oferta e kandidatit të përzgjedhur për kontratë.

Pika e parë e cekur më sipër mund të vërehet te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të paraqitura në dosje të tenderit. Komuna ka kërkuar nga ofertuesit të dërgojnë CV, diplomë në gazetari ose fusha të ngjashme, aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe shkrimit në gjuhën shqipe dhe angleze (preferohet edhe gjuha serbe) dhe referenca për vendet e punës.

26 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 56.5 pika 5. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (Qasur për herë të fundit 22.11.2024).

27 Vendimi nr. 02-035/1270 i Kryetarit të komunës së Vitisë, 2023.

Angazhimi i ekspertëve për përfaqësim në gjykatë

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2)

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në nëntor të vitit 2023, ka nisur procedurën e hapjes së tenderit “Kontraktor individual ekspert për çështje ligjore me kontratë për shërbime të veçanta”²⁸. Përmes këtij tenderi, MASHTI ka paraparë angazhimin e një eksperti për çështje ligjore për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA). Vlera e parashikuar e tenderit në fjalë është 7,500.00 euro për një periudhë kohore prej 12 muajve.

Sikurse edhe në shumicën e tenderëve të analizuar më lartë, problemet e njëjta shfaqen edhe në këtë rast, si: 1) përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e propozimeve teknike, 2) titulli i pozitës së konsulentit nuk është në përputhje me Rregulloren për Prokurim Publik.

Sa i përket kriterëve për vlerësimin propozimeve, tabela në vazhdim paraqet kriteret që kërkohen me Rregulloren e Prokurimit Publik në njëërën anë dhe ato që janë kërkuar/vlerësuar nga MASHTI ose Agjencia për të cilën është zhvilluar kjo procedurë.

Kriteret sipas Rregullore për Prokurim Publik

Kriteret e vlerësuara nga Agjencia

1	Përvoja përkatëse e këshilltarit	1	CV Referencat për përvojën e punës
2	Cilësia e metodologjisë së propozuar	2	Metodologjia
3	Kualifikimi	3	Diplomat / Certifikimet
4	Transferimi i njohurisë, nëse kërkohet	4	✗
		5	Oferta financiare
		6	Njohja e gjuhës angleze

28 E-prokurimi, tenderi me numër të prokurimit: 208 Udhëheqësi-23-13140-2-3-6.

Siç shihet nga tabela, MASHTI ka kërkuar dokumente si dëshmi për kualifikim (diploma), mirëpo në raportin e vlerësimit ky kriter nuk është peshuar me pikë, mirëpo ka vendosur disa nënkritere tjera si për shembull dëshmia për njohjen e gjuhës angleze e cila nuk do duhej fare të përfshihej si nënkriter i veçantë. Poashtu, oferta financiare do të duhej të përdorej pas vlerësimit teknik të propozimeve, duke bashkuar pikët teknike dhe financiare dhe duke i dhënë më se shumti 30 pikë.

Pastaj, sikur në shumicën e rasteve tjera, autoriteti kontraktues ka angazhuar ekspert për punë të cilat mund t'i mbulojë me stafin e rregullt. Përderisa përshkrimi i njohuri dhe përvojë në hartim të akteve administrative dhe njohuri në përfaqësim të institucionit në gjykatë, ose njohuri të legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë, do të thotë se detyrat nuk janë të natyrës për shërbim të veçantë e të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi aktual në agjenci. Sipas Rregullores për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKA, ekziston Divizioni për çështje ligjore, analiza, bashkëpunim ndërkombëtar dhe projekte ku janë të punësuar katër zyrtarë. Divizioni ka përshkrim të detyrave, si: ofrimi i këshillave, opinionëve ligjore për AKA-në, përfaqësimi në procedurat ligjore, pjesëmarrja në hartimin e legjislacionit që ndërlihet me punën e agjencisë, identifikimi dhe adresimi i zbrazëtimeve ligjore gjatë zbatimit të legjislacionit, etj²⁹.

Po ashtu, nëse analizojmë CV-në e kandidatit të rekomanduar për kontratë, vërejmë që përvoja e tij është e mangët sepse e vetmja përvojë profesionale është zyrtar ligjor në një kompani të tregtisë me pakicë, në të cilën ka punuar rreth dy vite. Sipas përshkrimit të punëve në CV, ka bërë hartim të dokumentacionit, përgatitje të raporteve, hartim të letrave zyrtare, monitorim i punës juridike, etj, që nuk dëshmojnë se kandidati ka ekspertizën për angazhim si specialist i një fushe specifike. Pavarësisht kësaj, MASHTI ka nënshkruar kontratë për një periudhë prej 12 muajve në vlerë prej 7,200.00 euro, ose rreth 600 euro në muaj.

Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2024 në Planifikimin përfundimtar të prokurimit³⁰ ka paraparë shërbime të përfaqësimit ligjor në vlerë prej 200,000.00 euro. Ky aktivitet i prokurimit është publikuar më 2 shkurt 2024 me procedurë të hapur³¹ dhe afati për dorëzim të ofertave ka zgjatë deri më 11 mars 2024. Kriteri i përzgjedhjes së ofertuesit është përdorur "Çmimi më i ulët i peshuar", edhe pse Rregullorja për Prokurimin Publik thekson se kontraktimi i konsulentëve duhet të bëhet përmes kriterit "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm". Për këtë tender kanë ofertuar tre operatorë ekonomik, dy prej të cilëve i'u është refuzuar oferta për arsyen se nuk kanë qenë më të lirat.

Ashtu si edhe në disa raste tjera, përfaqësimi ligjor është punë e zyrës ligjore apo departamentit ligjor dhe aspak nuk do të duhej të përdorej marrëveshja për shërbime të veçanta për angazhimin e personave për përfaqësim ligjor. Sipas organogramit të publikuar nga komuna e Prishtinës³², ekziston sektori ligjor i këtij institucioni. Sipas përshkrimit të punës së këtij sektori në webfaqen e Komunës³³, përveç tjerash zyrtarët kanë për obligim të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesin e komunës dhe të institucioneve që financohen nga komuna në procedurat gjyqësore civile, penale, përmbarese dhe administrative në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet. Pra, pikërisht për këtë është kërkuar që të angazhohet kompania kontraktuese. Punët të cilat do të kryejë kompania janë: përpilimi i parashtrësive dhe përfaqësimi në procedura penale, përpilimi i parashtrësive dhe përfaqësimi në procedura civile e të tjera. Në këtë rast angazhimi i një kompanie krijon strukturë të dyfishtë sepse sektori ligjor dhe kompania e kontraktuar kanë të njëjtin qëllim dhe punë. Edhe pse numri i madh i konteksteve gjyqësore është ngarkesë mjaft e madhe për zyrtarët përgjegjës, përdorimi i shërbimeve konsulente nuk paraqet zgjidhje të qëndrueshme.

29 Agjencia e Kosovës për Akreditim, Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës 2024, neni 9. <https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/23.01.2024-SQ-Rregullore-AKA-per-Organizimin-e-Brendshem-1.pdf> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

30 Uebfaqja e Komunës së Prishtinës, Plani i prokurimit 2024. https://prishtinaonline.com/uploads/planifikimi_i_prokurimit_2024_ak_prishtine_per_fundimtar.pdf (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

31 Vlen të ceket se në vitet paraprake, është përdorur procedura e negociuar.

32 Uebfaqja e Komunës së Prishtinës, Organogrami i Administratës së Komunës së Prishtinës, 2016 https://prishtinaonline.com/uploads/organo-grami_14.05.2019.pdf (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

33 Po aty, Sektori Ligjor.

Sipas të dhënave në webfaqen E-prokurimi³⁴, komuna e Prishtinës ka angazhuar kompani të tilla konsulente për përfaqësime ligjore që nga viti 2020. Tabela në vazhdim paraqet periudhën kohore, vlerat dhe kohëzgjatjen e punës për kompanitë e angazhuara nga komuna e Prishtinës për përfaqësim ligjor nga 2020 deri 2024.

Siç shihet në tabelë vlera e parashikuar për kontrata të tilla ka shënuar rritje çdo vit. Përgjatë këtyre katër viteve, Komuna ka lidhur pesë kontrata, për të kryer shërbime të përfaqësimit ligjor me vlerë prej 490,000.00 euro, kompani të cilat kanë qenë në shërbim të Komunës për 31 muaj në total.

	Autoriteti Kontraktues	Operatori Ekonomik	Vlera e parashikuar	Kohëzgjatja
2020	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	“Avokatura Istrefi” SH.P.K.	50,000.00	3 muaj
2022	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	“Avokatura Istrefi” SH.P.K.	60,000.00	4 muaj
2022	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	“Sejdiu & Qerkini” SH.P.K.	90,000.00	6 muaj
2023	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	“Sejdiu & Qerkini” SH.P.K.	90,000.00	6 muaj
2024	Kuvendi i Komunës së Prishtinës	PRO JURIS LAW FIRM L.L.C.; Tahiri & Partners SH.P.K.	200,000.00	12 muaj
Total			490,000.00	31 muaj

³⁴ E-prokurimi, Dokumentet në excel të shkarkuara nga kontratat e dhëna para 01.02.2021 dhe Kontratat e dhëna pas 01.02.2021. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327> (Qasur për herë të fundit më 22.11.2024).

Përfundime dhe rekomandime

DUKE U BAZUAR NË TRAJTIMIN E SHKELJEVE SIPAS TENDERËVE DHE INSTITUCIONEVE SI MË LARTË, MUND TË JEPEN DISA PËRFUNDIME SI NË VIJIM:

- 1** Institucionet publike të përfshira në raport, kanë shfrytëzuar MShV-të për angazhimin e kandidatëve për ofrimin e shërbimeve që nuk janë të veçanta apo specifike në një fushë të caktuar;
- 2** Institucionet publike të përfshira në raport, kanë shfrytëzuar MShV-të për angazhimin e kandidatëve jo në cilësinë e këshilluesit siç përcakton Rregullorja për prokurim publik, por për punë të rëndomta teknike-administrative të cilat duhet të mbulohen me staffin që ka institucioni;
- 3** MShV-të në disa raste të përfshira në këtë raport, janë shfrytëzuar për vazhdimin e angazhimit të personave që kanë qenë të angazhuar paraprakisht për 36 muaj po ashtu përmes kësaj procedure;
- 4** Institucionet publike të përfshira në raport në shumë raste nuk kanë përcaktuar kriteret e vlerësimit të kandidatëve, sipas Rregullores për Prokurim Publik. Në anën tjetër, janë kërkuar dokumente tjera shtesë që nuk lidhen me kriteret e përcaktuara me Rregulloren si më lartë;
- 5** Kriteri i cili më së shpeshti nuk është kërkuar nga institucionet publike ka qenë metodologjia e punës e cila tërheq nga 20 deri 50 pikë, mirëpo kandidatët janë angazhuar (pranuar) edhe pse nuk kanë dorëzuar këtë dokument;
- 6** Sipas raporteve të vlerësimeve në disa raste, vlerësimi nga institucioni përkatës kundrejt kriterëve të vendosura, nuk është bërë sipas Rregullores për Prokurim Publik e cila kërkon që secili kriter duhet të jetë i peshuar me pikë e grumbullimi i tyre për secilin kriter nxjerrë kandidatit fitues. Në kundërshtim me këtë, vlerësimi është bërë si grup i kriterëve të plotësuarara përmes shprehjeve “Në pajtim” apo “Nuk është në pajtim”;
- 7** Sipas raporteve të vlerësimeve në disa raste, kandidatët nuk i kanë plotësuar ato kriteret që janë vendosur nga institucionet, dhe përvoja e tyre e punës shumë shpesh nuk ka korresponduar me natyrën e punëve për çka ka aplikuar;

Sipas këtyre përfundimeve, mund të jepen një numër i rekomandimeve si në vijim:

- 1** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) duhet që në Ligjin e ri të Prokurimit Publik të rregullojë qartë dhe në mënyrë strikte kontraktimin e shërbimeve përmes MShV-ve;
- 2** Kapitulli i Ligjit të ri të Prokurimit Publik që rregullon lidhjen e MShV-ve duhet të draftohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), përkatësisht Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP) e cila është përgjegjëse për administratën publike në nivel lokal dhe qendror;
- 3** Ligji i ri për Prokurimin Publik duhet të shkurtojë afatin për të cilin kandidatët angazhohen përmes MShV-ve nga 36 në gjashtë (6) muaj sepse ofrimi i shërbimit të veçantë nuk është në proporcion me kohëzgjatjen prej 36 muajve;
- 4** Institucionet publike të përfshira në raport duhet të përdorin MShV-të për angazhimin e kandidatëve për ofrimin e shërbimeve specifike, të veçanta, të cilat nuk mund të mbulohen me pozitat e vendeve të punës të definuara me Katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil;
- 5** Institucionet publike të përfshira në raport duhet të përzgjedhin kandidatët që përmbushin të gjitha kriteret siç janë përcaktuar në Rregulloren e Prokurimit Publik, dhe mos të pranojnë të angazhojnë kandidatë të cilët nuk përmbushin njërin apo tjetrin kriter;
- 6** Institucionet publike të përfshira në raport duhet të bëjnë vlerësimin e përmbushjes së secilit kriter me pikë, siç përcaktohet me Rregulloren e Prokurimit Publik, dhe jo vlerësim të përgjithshëm sipas vlerësimit shabllon “Në pajtim” ose “Nuk është në pajtim”.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

